

LOYALTY ON LOW AND MORAL BELONGING IN SOCIETY BESNIKËRIA NDAJ LIGJIT DHE PËRKATËSIA MORALE NË SHOQËRI

ADRIANA ANXHAKU

Departamenti i Filozofisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Rruga “Millo Tutulani”
Tiranë, Shqipëri
adriana.anxh@gmail.com

AKTET V, 4: 527 - 530, 2012

PËRMBLEDHJE

Të kuptuar si rregullues ndërmjet interesave të njerëzve, ligji dhe morali synojnë të realizojë një unitet social në shoqëri. Mirëpo, jo rrallë na ndodh që, kur duhet të marrim një vendim të drejtë, besnikëria ndaj grupit tonë të ngushtë si familja, të afërmit, miqtë etj., është më e prekshme, se besnikëria ndaj ligjit. Disa nga mënyrat e ngushtimit të rrethit të besnikërisë në favor të bashkësisë së ngushtë janë të njohura te ne si nepotizmi, konflikti i interesave e deri te përbuzjet për njerëzit me prejardhje ose origjinë të caktuar gjeografike apo fetaro-kulturore. Të gjitha këto sjellin cënimin e të drejtave universale por edhe të veçanta të njeriut. Ndër gjetjet e këtij punimi mund të konsiderohet ideja, se dilemat për të drejtat, nuk janë dhe aq rezultat i konfliktit ndërmjet arsyes dhe ndjenjës, por ndërmjet projektimit të individit në grupet e ndryshme.

Fjalët çelës: Besnikëri ndaj ligjit, bashkësi, vlera morale, grup i ngushtë, konflikt.

SUMMARY

Being understood as regulator between interests of persons, law and moral aim at realizing a social unity in society. However, it often happens that, when we should take a right decision, loyalty to our group as close as family, relatives, friends etc., is more tangible, that loyalty to law. Some of the ways of reducing the circle of loyalty in favor of our close community or group are known to us as nepotism, conflict of interests up to contempt for people with certain geographical or religio-cultural origin. All these lead to violation of universal rights but also of special rights. Among the findings of this study we can consider the idea that dilemmas about the rights, are not so much a result of the conflict between reason and feeling, but between projections of the same individuals in different groups.

HYRJE

Të gjithë ne kemi dëgjuar ose jemi gjendur ndonjëherë në një situatë të tillë, ku kemi qenë të detyruar të vendosim besnikërinë ndaj një grupi të ngushtë, për shembull ndaj të afërmeve, fëmijës apo miqve para zbatimit të ligjit. Në rast se kjo mbrojtje fsheh një krim të rëndë karshi një personi tjetër, disa prej nesh mund t'i vrasë ndërgjegjja duke menduar edhe viktimën. Dilema jonë mund të nyjëtohet kështu: A duhet të mbështesim të afërmin, mikun tonë, apo drejtësinë?

Në vendin tonë, të gjendur shpesh në një komunitet, ku ekziston një njohje deri diku ndër njerëzit, shumë prej nesh do të ishin të gatshëm të mbronin të afërmin dhe jo ligjin. Duhet thënë që ky i fundit nënkupton në fakt besnikërinë ndaj një grupi më të gjërë, për shembull, ndaj qytetarëve të tjerë të vendit, ku hyn edhe viktimat.

Pse ngjet diçka e tillë? Kësaj pyetje do të përpiqem t'i përgjigjem në këtë punim.

1. Faktorë që kushtëzojnë zbatimin e ligjeve në komunitet

Mënyra e përfshirjes së individit në bashkësi si qytetar mbështetet në një kuptim drejtësie, qoftë edhe në trajtën e një të drejte natyrore bazë, ku ligji i shkruar natyrisht që nuk përbën të vetmin rregullator, sepse qytetarët mund të jenë besnikë edhe ndaj vlerave të tjera. Konkretisht, një situatë besnikërie është ajo të konsumuarit shqip, domethënë me përparësi të atyre produkteve që janë shqiptare, sepse kështu mund të zhvillohet biznesi shqiptar. Në këtë rast kemi të bëjmë me një lloj besnikërie ndaj një grupi apo komuniteti të caktuar, që për sytë tanë është mjaft e vlefshme moralisht, ndonëse mund të mos jetë e shkruar në ligj.

Çfarë e nxit atëhere mosbesimin dhe mosbesnikërinë ndaj ligjit? Duket se qytetarëve iu mungon një konceptim të tillë në disa raste:

a. Theksimi i teorive dhe vlerave të përkundërta morale, fetare, besimeve dhe pritshmërive nga shoqëria e redukton mundësinë e një njësimi të njerëzve mbi bazën e ligjit, si dhe besnikërinë ndaj tij. Kësisoj, kthimi i interesave nga gjuha e veçantë, kultura e grupit të ngushtë, kulti i origjinës në lidhje me rrënjët, janë shfaqje e kërkesave për identitet, specifikim. Kurse, siç thotë Canivez (Patrice) "Bashkësia e caktuar politike, është vetëm bashkësi e fakteve. Ajo i bashkon njerëzit me prejardhje dhe shprehje të ndryshme, që shohin se po jetojnë së bashku,, (1:21) Këtë rol gjithëpërfshirës i duhet të luajë drejtësisë së mishëruar në ligj.

b. Edukimi është një ndër faktorët kryesor të qëndrimit mosbesues ndaj ligjit dhe për rrjedhojë të moszbatimit të tij. Te fëmijët bindja për ligjin vjen para kuptimit se pse duhet zbatuar. Ai "e interpreton ligjin ose urdhërin si shprehje të vullnetit personal të të rriturit, pra si arbitraritet të tij." (1:41) Këto pasoja përforcohen në pjesën e mëvonshme të formimit të njeriut, në rast se ai vazhdon të mos e kuptojë ligjin dhe rëndësinë e zbatimit të tij për të lehtësuar disa veprime jetike, duke filluar qysh nga ecja në rrugë e deri te përdorimi i hapësirave të përbashkëta publike.

c. Ndikim për këtë mosbesim, ka dhe tradita diktatoriale, që i ka bërë shqiptarët me të drejtë dyshues përkundrejt ligjeve. Kjo sepse, sa e sa

herë ato duhet t'u bindeshin "porosive e ligjeve të partisë-shtet,, duke qartë se ishin urdhëra krejt arbitrare të njëshit diktatorial.

d. Ndërsa në demokraci, qytetarët janë bërë mosbesues ndaj atyre përfaqësuesve të ligjit, që u këshillojnë t'u bashkohen traditave perëndimore, me qëllim që të bëhen "më racionalë,, kur këto ligje duket se imponohen nga marrëveshjet e ndryshme rajonale e më gjërë, pa një kontekst vendor dhe pa një rishikim gjeopolitik të tyre në frymën e Monteskesjës.

e. Edhe mundësitë jo të barabarta çojnë në injorimin e ligjit. Tashmë janë të shumtë filozofët e së drejtës që mendojnë se garantimi i lirive politike mbetet i pazbatuar në realitet, kur nuk plotësohen nevojat bazë jetike të qytetarëve: "Pabarazia e dukshme e shanseve mund të krijojë te individit ndjenjë se është përjashtuar nga zhvillimi dhe progresi i shoqërisë. Në këtë rast ai do të mendojë se nuk ka çfarë të fitojë duke luajtur lojën shoqërore,, (1:91)- shkruan Canivez.

2. Vlera e zgjerimit të besnikërisë ndaj ligjit

Kur flasim për të drejta e njeriut, vërejmë se shumë prej këtyre të drejtave kanë ardhur duke u specifikuar e ngushtuar. Nga e drejta për qytetarët në përgjithësi, u bënë të drejta për burrat e për gratë, më pas të drejta për fëmijët, pakicat, moshën e thyer e deri te të drejtat për të sëmurët. Duke lidhur qenie të ndryshme me autoritetin e rregullës, ligjit i duhet të harmonizojë të dy këta elementë: Të mos çenojë shumë vlera e liri individuale, por nga ana tjetër, të kuptojë se detyrimi për të jetuar në një shtet nuk është vetëm farefisnor, miqësor, por edhe politik. Këtë antinomi e ka paraqitur mjaft mirë Rusoi kur thoshte që, ligji "të dënon të jesh i lirë".(7:34) Në kuptimin se, ligji duke qenë i njëjtë për të gjithë dhe mbipersonal, bën që, qytetari, i cili i nënshtrohet atij të mos i nënshtrohet asnjë individit të veçantë. Edhe kur zbaton urdhërat e eprorit, qytetari e bën sepse ai person e ushtron funksionin me ligj.

Një nga të mira bazë që vjen prej kësaj gjendje është se komuniteti ku funksionon ligji nuk lejon përdorimin e dhunës, si zgjidhje e problemeve dhe konflikteve. Individit gëzon të drejta të caktuara, por kryen edhe detyra të caktuara.

Te Rusoi gjejmë edhe këtë tezë tjetër që shpjegon domosdoshmërinë e besnikërisë ndaj ligjit: Duke mbrojtur të drejtat e të gjithëve, individit mbron edhe të tija. Në rast se bashkësia nuk përmbush një pjesë të kontratës ndaj individit, domethënë se të gjithë të tjerët janë të rrezikuar, dhe gjithkush do të tundohej që të mos kryente detyrimet e veta. Nga kjo kushtëzohet respekti i qytetarit ndaj ligjit. Këto janë disa arsye, se pse duhet ta zgjerojmë rrethin e bashkëpunimit në anë të drejtësisë.

3. Si mund ta zgjerojmë konceptin e bashkëpunimit brenda grupit?

Për këtë më duhet të sjell para syve tanë atë pikë të përbashkët që kanë morali dhe ligji si rregullatorë të interesave të grupeve e individëve. Ndryshe prej ligjit, morali nuk buron thjesht prej detyrimit, por si një marrëdhënie besueshmërie reciproke ndërmjet anëtarëve të një grupi të lidhur fort njëri me tjetrin, si për shembull, të një familje ose të një klani. Prandaj, në moral besnikëria ndaj grupit tonë të ngushtë është më e prekshme, sidomos kur gjendemi në situata ekstreme si lufta, përmytjet, apo fatkeqësi të tjera. Por nga ana tjetër kur shohim që të tjerët janë më keq, shumë prej nesh ndjehen mirë kur mbështesin ata që gjenden në fatkeqësi. Mendimi se të tjerët po pësojnë një padrejtësi i nxit mjaft njerëz ta shtrijnë besnikërinë e tyre përtej grupit të ngushtë familjar. Filozofi amerikan Richard Rorty thotë për këtë:

“Identiteti moral i njeriut është i varur nga grupi, ose nga grupet me të cilat ai identifikohet. Prandaj, njeriu nuk mund të jetë jobesnik ndaj këtyre grupeve, pa mohuar kështu edhe veten. Dilemat morale që vijnë nga ky qëndrim, nuk janë dhe aq rezultat i konfliktit ndërmjet arsyes dhe ndjenjës, por ndërmjet projektimit alternativ të njeriut në grupe të ndryshme.”(6:84)

Pyetja që shtrohet para ligjit është se si mund t'i bashkojë qytetarët, kaq të ndarë në besime e vlerësime morale të grupeve të tyre. Si do të përputhej, pra, një *koncept* i drejtësisë ligjore, i shtrirë në një grup sa më të madh njerëzish me *konceptimet* e ndryshme që gjenden në konflikt

me njëra-tjetrën për vlerat morale ku përfshihet edhe drejtësia? Rawls-i e përshkruan këtë kundërvendosje në këtë mënyrë:

“Njerëzve zakonisht ju pëlqen të jenë në një mendje lidhur me kuptimin e konceptit të drejtësisë, e njëkohësisht të mos jenë të bashkuar, sepse ata ndjekin parime e standarde të ndryshme mbi bazën e të cilave ata vendosin për gjërat.” (5:79) Ndërsa, prej “kontekstualizmit të fortë” të Habermasit del se nuk mund të kemi një racionalitet të vetëm, që të shërbejë si bazë për ligjin: “Në brendësi të kulturave, botëkuptimeve, traditave ose formave të ndryshme të jetës gjenden racionalitete të veçanta. Secili prej tyre duhet të brendashkruhet në një kontekst të të kuptuarit të veçantë për botën.” (2:208) Dhe duke qenë se kuptimi i arsyes dhe asaj çka është e arsyeshme mund të jetë krejt i ndryshëm sipas Habermasit, atëhere mënyra më e mirë teorike dhe praktike për të pasur një zgjerim të konceptit të besueshmërisë ndaj ligjit është përdorimi i institucioneve. Këto institucione dhe mënyra se si ato funksionojnë e bashkëveprojnë në respekt të ligjit mund të shërbejnë si model besueshmërie.

Një zgjidhje për të pasur një bashkësi morale dhe besnikërie më të gjërë, të tipit të ligjit e jep H. Kelsen, i cili duke analizuar vlerat e ndryshme morale që ekzistojnë në shoqëri na thotë: “Fakti që disa gjykime vlerore mund të jenë subjektive, pra dhe shumë të ndryshme deri dhe kontradiktore, nuk do të thotë që çdo individ ka një sistem të pavarur vlerash. Në të vërtetë shumë individë përputhen në gjykimet e tyre vlerore. Domethënë, një sistem pozitiv vlerash nuk mund të jetë një krijim arbitrar i një individ të veçuar, por gjithnjë është rezultat i një ndikimi të shumanshëm ndaj individit që gjendet brenda një grupi të dhënë, si familja, fisi, kasta, profesioni.” (4:21)

Kurse Rawls-i ofron si zgjidhje për këtë dy rrugë kryesore: Së pari, krijimi e bindjes te qytetarët që po bashkëpunojnë si persona të lirë e të barabartë. Domethënë, të atyre qytetarëve që janë të aftë të marrin përgjegjësi për qëllimet e tyre dhe për të përmbushur detyrimet shoqërore. Së dyti, krijimi i bindjes te ata, se jetojnë e drejtohen me sukses nga ligjet e jo nga dëshirat

subjektive të njerëzve. Racionalizimi i qytetarëve në këtë rast qëndron në të kuptuarit prej tyre, se rëndësia e pretendimeve të tyre përkundrejt institucioneve nuk varet nga fakti se sa të rëndësishme janë këto nevoja për individin, por edhe si bashkrendohen këto nevoja me ato të të tjerëve.

E duke qenë se shoqëria nuk është një sistem i mbyllur porse një sistem bashkëpunimi, mund të gjendet një bazë të mirash të përbashkëta, që kanë vlerë kryesore për jetën e njerëzve. Përbushja, sidomos e këtij kushti, nuk lejon cënimin e të drejtave bazë njerëzore.

Në këtë mënyrë, njerëzit mund të ndryshojnë besimet fetare, vlerat morale, botëkuptimet, por ata nuk e humbasin identitetin e tyre institucional që është i lidhur me këto të drejta bazë në shoqëritë demokratike.

4. Roli i edukimit në këtë proces

Edukimi me të drejtat e njeriut, do të thotë edukim me statusin e përdoruesit të mundshëm të ligjit. Ekziton një pikëpamje që e sheh “dhunën” e ligjit një kusht paraprak për të krijuar një bashkëpunim me detyrim. Për ta shprehur më thjeshtë, duhet t’u shtijmë frikën prej ligjit atyre që edukojmë. Me që ligji sipas idesë së Hartit nuk është vetëm sanksion por edhe ndihmës, madje ai përmban me shumë elementë të tillë ndihmës sesa sanksione, do të ishte mirë që pesha e edukimit me ligjin të anonte nga dobia dhe frytshmëria e zbatimit të tij për marrëdhëniet në bashkësi.

Gjithsesi, ajo që mund e duhet mbajtur parasysh në këtë proces është ideja se ligji nuk mund ta krijojë unitetin me forcë nga lart, por duhet te binden njerëzit e të brendësojnë ligjin në veprimet e tyre të përditshme. Hart-i e paraqet kështu një proces të tillë: “E drejta sepecifikon

disa sjellje të caktuara si standarde, qoftë për anëtarët e shoqërisë si një e tërë, qoftë për kategori të veçanta të saj. Këta individë ose kategori pritet t’i mësojnë rregullat edhe pa ndihmën, pa ndërhyrjen e autoriteteve, ata pritet të kuptojnë se rregullat zbatohen për ta dhe se duhet të veprojnë në përputhje me to.” (3:55)

Mirëpo, shumë prej nesh, me ose pa te drejtë, mund të dyshojnë në këtë aftësi vetedukeuese të njeriut me ligjin.

Ndërsa Rorty e përshkruan kështu këtë ecuri:

“Çdo marrëveshje e vendosur pa detyrim ndërmjet individëve dhe grupeve për atë se çka do të bëhet, dëshmon një formë përkatësie të përbashkët, që mund të çonte në stadin fillestar të zgjerimit të rrethit, ku të gjithë ata që bënin pjesë në të, t’i shohim tashmë si “disa prej nesh,„” (6:99)

Si përfundim: Zhvillimi i besnikërisë ndaj ligjit, konsiston në një sërë metodash e rrugësh të ndryshme që kanë një qëllim të përbashkët: Ta bindin (jo manipulojnë) qytetarin se jeton në një demokraci kushtetuese të cilën ja vlen ta mbrosh e ta përsosësh.

BIBLIOGRAFIA

- 1.Canivez, P: *Të edukohet qytetari*, Ese dhe tekste, Sh.b “Dukagjini”, Pejë 2004.
- 2.Habermas, J: *Erläuterungen zur Diskursethik*, Suhrkamp Verlag, Frankfurt a. Main, 1998.
- 3.Hart, H, L.A.: *Koncepti i së drejtës* (Concept of Law), Sh.b “ISP& Dita 2000”, Tiranë, 2010.
- 4.Kelsen, H: *Was ist Gerechtigkeit?* Philipp Reclam Verlag, Stuttgart 2007.
- 5.Rawls, J: *Political Liberalism*, Columbia University Preess, New York 1993.
- 6.Rorty, R: *Philosophie & die Zukunft*, Essays, Fischer Verlag, Frankfurt a.Main.